



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



Permbledhja e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

**Aktiviteti: “ Pulari per prodhim vezesh ” te Subjektit Fredi
Sh.p.k ne Fshatin Rrotull, Komuna Ishem , Durres**



Aktiviteti: Pulari per prodhim vezesh

Subjekti : Fredi sh.p.k

Investitori: Lulezim Kertusha

Vendndodhja: Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Pergatitur nga E & G 09 Sh.p.k

Prill 2014

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



Permbajtja

| | |
|--|----|
| 1. PERSHKRIM I PERGJITHSHEM..... | 4 |
| a. Informacion mbi VNM..... | 4 |
| b. Informacion mbi Subjektin “FredI” Sh.p.k..... | 4 |
| c. Vendodhja e projektit..... | 5 |
| 2. QELLIMI I AKTIVITETIT / PROJEKTIT..... | 8 |
| a. Aspekte te pergjithshme..... | 8 |
| 3. REFERENCA NE KUADRIN E PERCAKTIMEVE SHQIPTARE DHE NDERKOMBETARE..... | 10 |
| b. Legjislacioni shqiptar..... | 10 |
| c. Procesi I Vleresimit Te Ndikimit Ne Mjedis..... | 13 |
| 4. PERSHKRIMI I PROJEKTIT..... | 14 |
| a. Pershkrimi dhe organizimi i punes per aktivitetin “ Pulari per prodhim vezesh” ... | 14 |
| b. Energjia..... | 17 |
| c. Kerkesat e perdorimit te tokes dhe karakteristika te tjera fizike te projektit..... | 19 |
| d. Tipi dhe sasia e lendes se pare, energjise dhe burimeve te tjera te konsumuara.. | 19 |
| e. Mbrojtja nga zjarri..... | 20 |
| 5. PERSHKRIMI I MJEDISIT RRETHUES..... | 20 |
| a. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese. | 21 |
| b. Flora..... | 21 |
| c. Fauna..... | 22 |
| d. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia. | 22 |
| e. Uji, akuiferet, rruget ujore, brigjet..... | 22 |
| f. Relievi dhe klima..... | 23 |
| g. Trashegimia arkitektonike dhe historike. | 23 |
| h. Tiparet e tjera mjedisore. | 25 |
| i. Ushtrimi i aktivitetit dhe lidhja e tij me zonat e rendesise se vecante. | 25 |
| j. Perputhshmeria me planet e territorit..... | 25 |
| 6. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS DHE MASAT ZBUTESE..... | 26 |
| a. Shkarkimet ne toke..... | 26 |
| b. Shkarkimet ne uje..... | 26 |
| c. Shkarkimet ne ajer..... | 27 |
| d. Zhurmat. | 31 |

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



| | | |
|----|--|----|
| d. | Fenomene te tjera..... | 34 |
| e. | Permbledhja e masave zbutese..... | 35 |
| f. | Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese..... | 37 |
| 7. | TE DHENA PER DEMOGRAFINE, POPULLSIA DHE EKONOMIA..... | 37 |
| a. | Popullata dhe demografia e Komunes se Ishmit | 38 |
| 8. | PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTIT..... | 42 |
| 9. | SFIDA DHE PRIORITETE..... | 44 |

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



1. PERSHKRIM I PERGJITHSHEM

a. Informacion mbi VNM

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) është hartuar bazuar ne udhezimet dhe legjislacionin ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit ne pergjithesi dhe ne vecanti per ate te vleresimit te ndikimit ne mjedis. Raporti i VNM-se eshte pergatitur per te identifikuar ndikimet e mundshme qe mund te rezultojne nga funksionimi i aktivitetit “Pulari per Prodhim Vezesh ”. Ky raport i VNM-se eshte porositur nga subjekti Fredi Sh.p.k per rinovimin e lejes mjedisore per aktivitetin “Pulari per Prodhim Vezesh”, ne Fshatin Rrotull, Komuna Ishem, Durres. Pergatitja e raportit te VNM-se u realizua duke u bazuar ne raportin ekzistues te VNM-se te pergatitur per marrjen e lejes se mjedisit te meparshme, nga marrja e informacionit paresor nepermjet vizitave ne zonen ku zhvillohet aktiviteti i pularise, dhe nepermjet konsultimit te materialeve te publikuara ne kete fushe dhe te dhenave te tjera nga autoritetet shteterore dhe paleve te tjera te interesuara. Ky raport i VNM-se përfshin një vlerësim te pergjithshem te ndikimeve qe rezultojne si pasoje e veprimtarisë se ushtruar nga subjekti Fredi Sh.p.k.

b. Informacion mbi Subjektin “Fredi” Sh.p.k

Fredi Sh.p.k eshte themeluar dhe organizuar sipas Legjislacionit Shqiptar, objekti i se ciles ndodhet ne anen e djathte te rruges Shkafane – Shen Pjeter, ish – stallat e gjedhit te kooperatives bujqesore Ishem. Fredi Sh.p.k kryen aktivitetin e “Pulari per

FREDI Sh.p.k



Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083

| | |
|---|---|
|  <p>“ FREDI” Sh.p.k</p> | <p>E&G 09 shpk</p>  |
|---|---|

prodhim vezesh”. Subjekti “Fred Sh.p.k” ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Adresa Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres.

Administrator: Lulezim Kertusha

c. Vendodhja e projektit

Objekti ndodhet ne anen e djathte te rruges Shkafane – Shen Pjeter, ish – stallat e gjedhit te kooperatives bujqesore Ishem. “Fred Sh.p.k zoteron nje siperfaqe prej 674 m² , e pozicionuar ne ne territorin e Komunes Ishem, ne fshatin Rrotull, ne largesi 300-400 nga rruga per ne Ishem. “Fred Sh.p.k eshte pajisur me leje mjedisore Nr. Prot. 818, date 11/12/2008, me vendim nr. 16 te Komisionit te Lejeve, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave per aktivitetin “Pulari per prodhim vezesh” ne Komunen Ishem.

Ne figurat e meposhtme jepet vendndodhja e subjektit “Fred Sh.p.k.

| | |
|--|---|
| <p>FREDI Sh.p.k</p> <p>Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres</p> | <p>Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169 Tirana - Albania infoeg09@gmail.com mobile: +355 696032083</p> |
|--|---|



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk




Figura nr.1. Pamje nga hapesira per vendodhjen e aktivitetit te “Fredri” sh.p.k

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169
Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



Figura nr.2. Pamje nga hapesira per vendodhjen e aktivitetit te “FredI” sh.p.k

Vendodhja e objektit eshte ne koordinatat gjatesi 19°32`00 E (lindje) / gjeresi gjografike 41°21`17``N (veri)

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169
Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



2. QELLIMI I AKTIVITETIT / PROJEKTIT.

a. Aspekte te pergjithshme

Qellimi i projektit eshte pershtatja e objektit ekzistues dhe venia ne shfrytezim e kapanoneve per rritjen e zogjve brojler per prodhim vezesh dhe respektivisht per pulat. Ne bujqesine e vendeve te zhvilluara tre prirjet kryesore jane:

- Rritja e specializimit;
- Rritja e intensitetit te prodhimit;
- Rritja e intensitetit te mekanizimit e shoqeruar me uljen e intensitetit te punes.

Presionet ekonomike dhe sociale kane imponuar keto prirje, te cilat duket se do te ekzistojne dhe ne te ardhmen. Shume vende ne zhvillim kane pranuar nevojen e pershtatjes se metodave te reja, te pakten pjeserisht, me nje perpjekje per te transformuar bujqesine e tyre nga nje sistem per ekzistence ne nje aktivitet tregtar.

Perdorimi i impianteve blegtorale eshte shembulli i pare i ketij transformimi. Nga ana konceptuale, impiantet blegtorale zbatojne parimet e prodhimit masiv industrial te produkteve blegtorale.

Kafshet rriten ne kushte te nje dendesie te madhe, ne struktura te izoluara nga mjedisi i jashtem, dhe te pajisura me sisteme mekanike ose te automatizuara ventilimi, te ushqyerjes dhe te furnizimit me uje te pijshem. Disa vende europiane kane filluar te perdorin impiantet blegtorale te rritjes intensive qe ne fillim te viteve '50. Nderkohe disa vende ne zhvillim filluan te adoptojne kete teknike ne nje fare shtrirje. Impiantet blegtorale te rritjes intensive filluan te shfaqen dhe ne SHBA ne fund te viteve ' 50. Rritesit e pulave ishin te paret qe perdoren keto sisteme intensive

FREDI Sh.p.k



Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083

| | |
|---|---|
|  <p>“ FREDI” Sh.p.k</p> | <p>E&G 09 shpk</p>  |
|---|---|

blegtorale. Ne fillimet e viteve '60 filloi gjithashtu dhe industria e rritjes se derrit te adoptoje kete teknike, e pasuar me vone nga rritesit e bagetise se imet.

“Fredri” Sh.p.k zhvillon aktivitetin “Pulari per prodhim vezesh” ne komunen Ishem, Durres. Subjekti “Fredri” Sh.p.k nisur nga themelimi e ne vijimesi realizon aktivitetin e tij me sukses, duke permbushur objektivat e vendosura si ofrimin e sherbimit te prodhimit te vezeve per subjekte dhe individe te interesuar. Subjekti “Fredri” Sh.p.k ndjek e zbaton praktikat me te mira te sigurise dhe shendetit ne pune. Subjekti “Fredri” Sh.p.k ka nje strukturë organizative dhe administrative efikase dhe fleksibël qe ka si perparesi zhvillimin e qendrueshem. Prandaj subjekti “Fredri” Sh.p.k ka pergatitur dhe hartuar projektin e zbatimit, i pergatitur nga specialiste te kualifikuar dhe me eksperience ne fushen e ndertimit dhe te venies ne shfrytezim te pularive. Gjithashtu, subjekti “Fredri” Sh.p.k ka porositur dhe “Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis” si pjese e dokumentacionit te nevojshem per te marre miratimet e duhura nga institucionet perkatese.

Objektivat e VNM-se konsistojne ne analizimin e faktoreve pozitive e negative mjedisore, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative si dhe tenton ne permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit gjate shfrytezimit te kompleksit blegtoral.

Qellimi i VNM-se eshte, qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te ndikimeve te pritshme te ketij aktiviteti te bazuara ne kriteret e standarte shkencore nderkombetare, te tipizohen dhe te perzgjidhen nje sere parametrash dhe vecorish te sistemeve natyrore, ne sherbim te infrastruktures mjedisore, te infrastruktures urbane si dhe shfrytezimit te kompleksit blegtoral etj.

| | |
|--|---|
| <p>FREDI Sh.p.k</p> <p>Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres</p> | <p>Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169 Tirana - Albania infoeg09@gmail.com mobile: +355 696032083</p> |
|--|---|



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



Ky raport ka per qellim te sherbeje:

- Si instrument per mbrojtjen e mjedisit;
- Ne fuqizimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;
- Ne kontrollin e perdorimit te qendrueshem te burimeve natyrore;
- Ne rritjen e mireqenies nga menaxhimi afatgjate i komplekseve blegtorale;
- Ne mbrojtje te pasojave financiare dhe socio-ekonomike;
- Ne rritje te interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja; etj

3. REFERENCA NE KUADRIN E PERCAKTIMEVE SHQIPTARE DHE NDERKOMBETARE.

b. Legjislacioni shqiptar

Legjislacioni shqiptar ne fushen e mjedisit synon te jete ne perputhje me direktivat dhe standartet e Bashkimit European. Procesi i transpozimit dhe parafrimit te Legjislacionit Mjedisor eshte bere me intensive qe prej nenshkrimit MSA ne vitin 2005. Aktualisht, Qeveria Shqiptare eshte ne procesin e pershpejtimit te procesit te transpozimit teresor te legjislacionit ekzistues dhe synon transpozimin e plote per gjithë aktet e reja ligjore dhe nenligjore qe jane ne proces apo qe do te pergatiten dhe miratohen ne te ardhmen. Megjithese ne Shqiperi, ligji i pare per çeshtjet mjedisore eshte aprovuar qe ne vitin 1967, kuadri ligjor per ceshtjet e mjedisit eshte zhvilluar ne menyre te qenesishme duke filluar qe prej viti 1991 me krijimin e Komitetit te Mbrojtjes se Mjedisit dhe sot me Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave krijuar qe ne vitin 2002. Ne vite Shqiperia ka pergatitur nje baze te gjere ligjore per aspekte te ndryshme te mjedisit si dhe ka nenshkruar dhe eshte pale ne shume konventa nderkombetare per mjedisin.

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



Kuadri ligjor për procedurën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) në Shqipëri ka pesuar ne vazhdimesi permiresime qe nga miratimi i Ligjit Nr. 8990 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor, miratuar më 23 Janar 2003. Aktualisht jane miratuar dy ligje qe rregullojne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe lejet mjedisore qe jane:

- ✚ Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”
- ✚ Ligji Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Per Lejet e Mjedisit”;
- ✚ Ligji Nr.60/2014 "Per Lejet e Mjedisit te Tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi".
- ✚ Vendim i KM Nr. 419, date 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".
- ✚ Vendim i KM Nr. 417 date 25.06.2014 "Per miratimin e tarifave te lejeve te Mjedisit".
- ✚ Urdhëri Nr. 321 datë 11.2.2014 "Për Lejet Mjedisore".
- ✚ Udhezim nr. 3 date 02.12.2013 "Per dokumentacionin e duhur per Leje Mjedisore";
- ✚ Urdhër nr. 6, i datës 27.12.2006, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin paraprak të ndikimit mjedisor të një aktiviteti”; 2006;
- ✚ VKM nr. 538, i datës 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet të trajtuara nga / ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit"; 2009
- ✚ VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore”

Procedura dhe praktika ekzistuese për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Shqipëri mund të përmblihet në dy fazat kryesore qe jane kategorizimi i llojit te veprimtarise

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



sipas llojit dhe kapacitetit dhe pergatitja e dokumentacionit te nevojshem dhe aplikimi per leje mjedisi.

Procesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe pergatitja e dokumentacionit te nevojshem ne vetvete kalon ne disa hapa si vijon:

- ✚ Prosesi i percaktimit nese nje projekt i caktuar ka nevoje per vleresim te ndikimit ne mjedis dhe nese po, percaktimin nese duhet te jete i permbledhur apo i shkurtuar. Investitori per nje aktivitet te caktuar eshte pergjegjes per perzgjedhjen dhe kontraktimin e eksperteve mjedisore, qe orientojne investitorin te percaktoje nese aktiviteti ka nevoje per leje mjedisore dhe cfare forme te saj. Gjithashtu, subjekti eshte pergjegjes qe nepermjet eksperteve te mjedisit te pergatise raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis;
- ✚ Pergatitja e draft raportit te VNM-se dhe te projektit teknik;
- ✚ Faza e Konsultimeve me Publikun te interesuar dhe qe jetojne ne afersi te zones, ku propozohet nje projekt i caktuar. Investitori eshte pergjegjes per ofrimin e gjithë logjistikes se nevojshme per organizmin e konsultimeve. Pushteti vendor merr rol drejtues dhe ARM-te jane vezhguese dhe asistuese ne kete proces;

Aplikimi per leje mjedisi kalon fazat e meposhtme

- ✚ Aplikimi per leje mjedisi: Kërkesa për lejen e mjedisit dorëzohet tek Qendra Kombëtare për Licensim, (QKL) e cila i përcjell dokumentat tek Drejtorise se Lejeve te Agjensise Kombetare te Mjedisit (AKM), Ministriae Mjedisit (MM).
- ✚ Mendimi i Drejtorise Rajonale te Mjedisit (ARM): MM i përcjell dokumentat tek ARM, këto të fundit vlerësojnë dokumentat, kryejnë vrojtime në terren dhe përgatisin mendimin e tyre për projektin, përfshirë këtu dhe kërkesat e posaçme për lejen.
- ✚ Miratimi i kushteve te lejes se mjedisit: Duke marrë në konsideratë mendimin e ARM, struktura te AKM, MM miratojne lejen dhe kushtet perkatese dhe ia percjellin Qendres Kombetare te Licensave.

FREDI Sh.p.k



Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083

| | |
|---|---|
|  <p>“ FREDI” Sh.p.k</p> | <p>E&G 09 shpk</p>  |
|---|---|

✚ Shpallja e lejes se mjedisit behet nga QKL-ja.

c. Procesi I Vleresimit Te Ndikimit Ne Mjedis

Procesi i VNM-se per aktivitetin Pulari per prodhim vezesh ” përfshiu:

- Identifikimin e ndikimeve mjedisore te projektit
- Vlerësimin e ndikimeve te alternativave te projektit
- Rekomandimin e proceseve te përshtatshme apo zhvillimin e strategjive duke konkluduar si rrjedhoje me përgatitjen e një raporti te VNM-se sipas karakteristikave te projektit te parashikuar.

Procesi i vlerësimit përfshiu analizat e ndikimit dhe masat zbutëse sipas fazave te mëposhtme te projektit:

- Faza e projektimit;
- Faza Funkcionimit;
- Faza e Perfundimit te Projektit.

Procesi i VNM-se është bazuar mbi kerkesat, udhezimet e legjislacionin shqiptar.

Procesi i ndërmarrë per përgatitjen e raportit te VNM-se, përfshiu

- ↔ Krahasimin e ndikimeve te projektit,
- ↔ Metodatat e operimit (shfrytëzimit) dhe
- ↔ Masat zbutëse te propozuara për normat dhe standardet kombëtare.

Këto përfshijnë vlerësimin e projektit te propozuar dhe ndikimin e tij te mundshëm mbi mjedisin, ne perputhje me normat e ndotjes ne mjedis ne fuqi.

Si pasoje e natyrës dhe shkalles se procesit te projektit qe zhvillohet ne këtë raport, sipas shtojces II te ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, aktiviteti Pulari per prodhim vezesh ” klasifikohet ne kategorine e projekteve

| | |
|--|---|
| <p>FREDI Sh.p.k</p> <p>Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres</p> | <p>Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169 Tirana - Albania infoeg09@gmail.com mobile: +355 696032083</p> |
|--|---|

që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis në grupin e lejeve të tipit B.

4. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

a. Pershkrimi dhe organizimi i punës për aktivitetin “ Pulari për prodhim vezesh” .

Subjekti “Fredri” Sh.p.k me numër Nipti K01404504O, ka filluar aktivitetin e tij që më 03/09/1997 me objekt “ Prodhim dhe tregetim vezesh dhe pula “.




Figura nr. 3 Paraqitja skematike e elementeve kryesore të aktivitetit të “Fredri” Sh.p.k

Elementet përberës të aktivitetit “Pulari për prodhim vezesh” janë :

- Impianti i rritjes së zogjve (brojler) dhe pulave (3 kapanone)



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



- Zyra
- Kabina e rojes
- Mjediset per punetoret, garderoba dhe mjediset sanitare
- Mini-impianti i pergatitjes se ushqimit
- Magazina e prodhimit te ushqimit
- Kabina elektrike

Ne kompleks futen zogj 24 oresh. Nga aktiviteti “Pulari per prodhim vezesh” i subjektit “Fredit” Sh.p.k prodhohen :

-Ne muaj 182.977 kokrra veze

-Rreth 15 Kv pleh ne 24 ore (pleh organik)

- Subjekti “ Fredi ” Sh.p.k disponon 3 kapanone me kapacitet mbajtes:
 1. Kapanoni 1: 10.500 krere (Rritje e pulave dhe prodhim vezesh)
 2. Kapanoni 2: 13.000 krere (Rritje e pulave dhe prodhim vezesh)
 3. Kapanoni 3: 15.000 krere (Rritje e zogjve)

Kapanonet ku rriten pulat jane te konstruksionit mur tulle me solete. Ne pjesen fundore te kapanonit jane instaluar sistemet e ventilimit, te cilet funksionojne ne rast te rritjes se temperatures ose nivelit te gazeve ne mjediset e kapanoneve. Cdo kapanon eshte i pajisur me rafte 4- kateshe. Cdo kat eshte i pajisur me transportier polietilen qe sherben per transportin e mbetjeve organike, jashte kapanoneve. Ambienti i kapanoneve sperkatet, per te realizuar lageshtine e nevojshme ne rast se temperatura ne brendesi te kapanoneve eshte me e madhe se 23°C. Ne keto kapanone ndodhen rreth 21 mije krere pula. Ato riperterihen cdo 18-20 muaj. Zevendesimi behet ne kohen qe pjelloria e vezeve ulet. Gjate zevendesimit behet dezinfektimi i kapanoneve me formaline dhe dezinfektant te tjere per zhdukjen e mikrobeve dhe insekteve te semundjeve qe mund te jene prezente.

- Ekstrementet (jashteqitjet) e pulave dhe zogjve jane rreth 38 ton ne muaj, dalin nga kapanoni ne menyre mekanike nepermjet elevatorit me transportier i cili del jashte ne nje lartesi te tille qe nen te te futet kamioni me kazan vetshkarkues nga ku merren keto jashteqitje dhe dergohen ne tokat ne prone te fshatareve te zones per ti perdorur per pleherim organik (kjo realizohet nepermjet marreveshjeve qe subjekti ka bere me fshataret e zones). Plehu i prodhuar nga mbareshtimi i pulave nxirret ne menyre periodike cdo dy dite me mjete te percaktuara.

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



- Mini impianti i pergatitjes se ushqimit eshte i perbere nga:

1. Silloset e lendeve te para
2. Mulliri i bluarjes
3. Perzieresi
4. Sillosi i ushqimit te pergatitur me kapacitet 1 ton
5. Sistemi i shnekeve qe furnizon baterite e pulave me ushqim te gatshem

Subjekti perdor rreth 138.15 Kv ushqime ne muaj. Si lende e pare per prodhimin e ushqimeve per shpendet perdoret: Soje, miser, luledielli, karbonat, dhe mikroelement te teknologjise bashkohore te standarteve per kete qellim.

Lendet e para depozitohen e perpunohen ne magazinen e prodhimit te ushqimit dhe te ruajtjes se lendes se pare.

- Ne magazinen e prodhimit te ushqimit, prodhohet ushqim i gatshem me receptura te vecanta per secilen kategori kafshesh. Cdo recepture sipas teknologjise se pergatitjes ka kohen dhe sasine e caktuar. Ushqimet e pergatitura me pas , nepermjet nje sistemi transportues me shnek, vendosen ne depo te vecanta dhe ketu kalojne ne dozatore, nepermjet kareleve (transportuesve). Here pas here, sipas nje programi behet dezinfektimi i magazines dhe ambienteve ku ruhen lendet e para. Ushqimet e gatshme per konsum prodhohen ne menyre kompjuterike sipas udhezimeve te marra nga operatoret. Ushqimi i pergatitur permban keto perberes :

1. Nenprodukte te drithrave
2. Vaj zooteknik
3. Bersi te ndryshme
4. Lende minerale
5. Kompleks vitaminash

Vaji i perdorur vjen kryesisht nga importi dhe ruhet ne cisterna 1000 liter nga ku kalon ne fabrike duke marre pjese ne procesin teknologjik sipas recepturave perkatese. Ky produkt vjen me mjete te caktuara; per cdo parti malli kryhen analizat. Lendet minerale dhe aditivet te cilet jane perberes te rendesishem ne receptura, vijne nga importi te ambalazuara ne thase te mbyllur, ruhen ne vende te vecanta dhe gjate kohes se perdorimit, personi i caktuar eshte i pajisur me te gjitha mjetet e nevojshme mbrojtese. Magazina ka te gjitha rjetin e nevojshem kullues per ujerat

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



natyrale pasi nuk ka mbeturina qe derdhen ne to. Nuk krijohen permytje qe te behen burim semundjesh dhe infeksionesh, te cilat te ndikojne ne cilesine e ushqimeve te gatshem dhe ne komunitetin perreth.

- Uji qe perdoret per zogjte dhe pulat shfrytezohet nga sistemi i ujesjellesit te zones lokale. Depozitat ne te cilat grumbullohet uji fillimisht kane kapacitet 20 ton, me tej uji kalon ne depozita me kapacitet 2 ton qe sigurojne uje te pijshem per nevojat e pularise. Furnizimi me uje i impiantit te pulave realizohet nepermjet nje sistemi automatik te shperndarje se ujit (sistemi niples), qe konsiston ne pirezeh uji “biberon”. Nepermjet ketij sistemi uji eshte i gatshem per tu konsumuar ne cdo moment me nje temperature 18-20°C.

Subjekti “Fredy” Sh.p.k gjithashtu eshte i pajisur me dhoma te vecanta per pushimin, ngrerien dhe garderoben e punetoreve. Ne ambientet e objektit zbatohen te gjitha masat karantinore dhe te sigurimit teknik. Behet pulverizimi ne tere kubaturen me solucion te holluar jodi qe garantojne sterilizimin e mjedisit te brendshem dhe te jashtem perreth kompleksit nga ngarkesat e mundshme mikrobike. Subjekti “Fredy” Sh.p.k ka ngritur gropat dezinfektuese ne te gjitha hallkat e prodhimit per te mos lejuar depertimin e infeksioneve te ndryshme. Shpendet e ngordhur groposen ne vendin e caktuar per kete qellim.

b. Energjia.

Subjekti “Fredy” Sh.p.k furnizohet me energji elektrike nga Infrastruktura e rrjetit elektrik ekzistues te komunes Ishem.

Tabela nr.1 Perdorimi dhe sigurimi I energjise

| | PO | JO | Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin) |
|--|----|----|--|
| A perdoret energji ? | Po | | Subjekti furnizohet me energji nga rrjeti shperndares se CEZ-it. |
| A prodhohet kjo energji ne territorin e impiantit apo sigurohet nga burime te tjera? | | Jo | Kjo energji merret nga rrjeti elektrik ekzistues |
| Konsumi I lendeve | | Jo | |

FREDI Sh.p.k



Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083

| | |
|---|---|
|  <p>“ FREDI” Sh.p.k</p> | <p>E&G 09 shpk</p>  |
|---|---|

| | | | |
|---|--|--|---|
| diegese per sigurimin e energjise nese prodhohet me impiant/instalim? | | | |
| Sqarime te tjera? | | | Subjekti zoteron dhe nje gjenerator qe nuk e ka perdorur nisur nga fakti qe ska pasur mungese te energjise elektrike. |

Tabela nr.2 Konsumi I energjise dhe ujit

| KONSUMI I ENERGJISE | |
|----------------------------|--|
| Burimi | Konsumi ditor dhe total ne baze viti (kwh/g, t/g, dhe te ngjashme) |
| Energji elektrike | Konsumi mesatar ditor ne baze te diteve te punes 161.1 kWh/dite |
| KONSUMI I UJIT | |
| Burimi I furnizimit | Me nenkontraktor |
| Rrjeti publik | |
| Pus personal | Po |
| Informacion tjeter sqarues | Subjekti “FredI” Sh.p.k ka ndertuar nje pus, ku ka montuar nje elektropompe zhytese, nga ku merret uji per procesin teknologjik, pastrimin, lagien e ambientit, si dhe ne rast te renies se zjarrit. Nevoja per uje eshte 4 m ³ uje / dite. |

| | |
|--|---|
| <p>FREDI Sh.p.k</p> <p>Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres</p> | <p>Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169 Tirana - Albania infoeg09@gmail.com mobile: +355 696032083</p> |
|--|---|



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



c. Kerkesat e perdorimit te tokes dhe karakteristika te tjera fizike te projektit.

Kompleksi I pularise “Fredy” Sh.p.k ndodhet ne zonen fushore te fshatit Lalez te Komunes se Ishmit. Ne baze te aktit te pronesise prona perbehet:

- Siperfaqe toke truall ----- 11.700 m²
- Siperfaqe ndertimi ----- 874 m²
- Salla nr. 1 e pularise ----- 532 m²
- Salla nr. 2 e pularise ----- 342 m²

Stalla ka konstrukcion me skelet beton arme, mure tulle e mbulesa me solete, ndersa dyshemeja eshte me beton te ilustruar. Stalla eshte e pajisur me te gjitha makinerite e pajisjet teknologjike te kohes per Pulari prodhim vezesh.

d. Tipi dhe sasia e lendes se pare, energjise dhe burimeve te tjera te konsumuara.

Tabela nr.3 –Lendet e para te perdorura

| | PO | JO | Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin) |
|---|----|----|---|
| A perdorni lende te para ? | | Jo | Subjekti “Fredy” Sh.p.k perdor lendet e para si me poshte shenuar: <ul style="list-style-type: none"> - bersi soje; - bersi luledielli; - miser; - nukleotid misri + metionin; - vaj pularie; - grure. |
| A perdorni material ndihmese? | | Jo | |
| A perdorni perzierje materialesh? | | Jo | |
| A perdorni lende diegese (dhe/ose energji) ? | | Jo | |
| A perdorni kimikate sintetike/laboratorike | Po | | Subjekti “ Fredi “ Sh.p.k perdor aditivet e |

FREDI Sh.p.k



Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083

| | |
|---|---|
|  <p>“ FREDI” Sh.p.k</p> | <p>E&G 09 shpk</p>  |
|---|---|

| | | | |
|--|---|--|---|
| ? | | | meposhtem: <ul style="list-style-type: none"> - Lizine - Fosfat - Bikarbonat sode - Natufos |
| Lutem vendosni materialet sipas volumeve qe perdoren | <ul style="list-style-type: none"> - <i>Bersi soje</i> \Rightarrow 81.900 kg / vit - <i>Bersi luledielli</i> \Rightarrow 1000 kg / vit - <i>Miser</i> \Rightarrow 115.967 kg / vit - <i>Nukleotid misri + metionin</i> \Rightarrow 385 kg / vit - <i>Vaj pularie</i> \Rightarrow 730 kg / vit - <i>Grure</i> \Rightarrow 4.220 kg / vit - <i>Lizine</i> \Rightarrow 275 kg / vit - <i>Fosfat</i> \Rightarrow 1.325 kg / vit - <i>Bikarbonat sode</i> \Rightarrow 28 kg / vit - <i>Natufos</i> \Rightarrow 20 kg / vit | | |

e. Mbrojtja nga zjarri.

Aktiviteti “ Pulari per prodhim vezesh “ nuk eshte nje aktivitet me rrezikshmeri te larte te zjarrvenies. Megjithate, kompania ka instaluar sisteme hidrant, depozita uji, si dhe eshte pajisur me fikese zjarri me shkume per te evituar zjarrin ose perhapjen e tij ne cdo rast. Hidrantet furnizohen me uje nga tubacione celiku dhe mbulojne teresisht territorin e jashtem dhe te brendshem. Uji eshte siguruar nga subjekti me investimet e veta duke krijuar nje pus i cili perdoret per qellimet e kompleksit. Punetoret trajnohen vazhdimisht per rrezikun e shperthimit te zjarrit dhe per shuarjen e tij ne rast rreziku.

5. PERSHKRIMI I MJEDISIT RRETHUES

| | |
|--|---|
| <p>FREDI Sh.p.k</p> <p>Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres</p> | <p>Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169 Tirana - Albania infoeg09@gmail.com mobile: +355 696032083</p> |
|--|---|



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



a. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.

Bregdeti i Ishmit është pjesë e gjirit të Lalzit, i cili shtrihet nga Bishti i Pallës në jug, deri në kepin e Rodonit në veri. Kjo pjesë e bregdetit të Adriatikut karakterizohet nga një brez mjaft i gjerë ranor, i kufizuar nga një brez hijerëndë pishash në pjesën më të madhe të gjatësisë së tij; rërë e ashpër; si edhe ujëra të kthjellëta. Zona është shfrytëzuar shumë pak për qëllime turistike – para viteve 90 kjo pjesë e bregdetit ka qenë zonë ushtarake e aksesit në të i palejuar. Edhe më vonë, mungesa e infrastrukturës ka bërë të mundur që zona të mbetet pothuajse e virgjër dhe vetëm vitet e fundit vërehet një rritje e interesit për këtë pjesë të bregdetit. Brezi i gjerë ranor, ujërat e pastra dhe bimësia janë disa nga tiparet që e bëjnë shumë tërheqëse zonën nga pikëpamja turistike. Bregdeti ranor ndërthuret me pjesën kodrinore të Ishmit, e cila karakterizohet nga një gjelbërim i rrallë, me pyje të vjetër e të rinj, nga ajër i pastër e një peisazh i mrekullueshëm që shoqërohet nga poshtë me një det të kaltër dhe një rërë e artë. Pyjet e dendur me lisa të lartë, drurë ahu që rriten në lartësi 30 m mbi nivelin e detit dhe një bimësi e pasur dhe shkurre të rralla mesdhetare e bëjnë mjaft interesant Ishmin si territor turistik me të ardhme. Vlejnë për t’u përmendur edhe vlerat e peisazhit të zonave kodrinore dhe kapacitetet që ato kanë për zhvillimin e turizmit në natyrë dhe agroturizmit. Në territorin e këtyre zonave kodrinore ekziston edhe mundësia e turizmit sportiv si shëtitje me kuaj, shëtitje me këmbë e biçikleta, sporti i golfit etj.

b. Flora

Zona e Ishmit futet në zonën e bimësisë mesdhetare në zonën e makjes. Rriten bimë me gjelbërim të përhershëm dhe shkurret mesdhetare si lisi, shkoza. Në Zonën e Kepit, duke qenë se gjatë viteve 1945 – 1990 ishte zone ushtarake, është ruajtur më së miri bimësia. Numri i bimëve njihet rreth 1,500 të tilla. Në zonën ku do sistemohet parcela e perpunimit të mbetjeve të pularisë nuk ka vegjetacion, pasi është tokë bujqësore. Gjithashtu është zone e destinuar edhe për ndërtim të objekteve që i shërbejnë bujqësisë. Vlerë natyrore e Ishmit është edhe sipërfaqja e madhe me pyje ku speciet dominante janë lisi, shkoza, frashëri, dëllenja, murrizi dhe bashkë me ato edhe një faunë e pasur. Krahas bimësisë natyrore kultivohen edhe drurë frutore si ulliri, agrumet dhe rrushi.

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



c. Fauna

Fauna e zones gjithashtu nuk mund te konsiderohet e pasur vecanerisht ne siperfaqet perreth godines nuk ka kushte qe te zhvillohet fauna. Kafshët më të përhapura janë: dhelpra, lepuri, çakalli, rosa dhe pata e egër, mëllenja, zogjtë shtegtarë, fazanë etj . Ne zonen ku do sistemohet parcela e perpunimit te mbetjeve te pularise nuk ka faune te pasur. Mund te gjenden me shume reptile e zvarranike. Fauna e pranishme është gjithashtu mjaft e veçantë, që fillon nga delfinët tek breshka e rrallë e detit, nga levreku e dentali tek krap i ujërave të ëmbla. Ujërat janë mjaft të pasura, pasi nuk janë shfrytëzuar si pjesa tjetër e bregdetit të Adriatikut dhe janë të përshtatshme edhe për peshkim apo zhytje. Po kështu, fauna e pyllit është gjithashtu e pasur, nga lepuri I egër tek shpendët e shumëllojshëm dhe mund të zgjojë interesin e të apasionuarve të gjuetisë.

d. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.

Siperfaqja ku eshte vendosur subjekti eshte zone bregdetare fushore dhe toka eshte kryesisht ranore me terren te sheshte, ku mungon tektonika. Peisazhi nuk do kete ndryshime nga vazhdimi i aktivitetit ne fjale. Ishmi është i pasur me tokë, pyje e kullota.

e. Uji, akuiferet, rruget ujore, brigjet

Lumi Ishëm përshkon fushën në lindje të fshatrave ne perberje te komunes Ishem deri në grykëderdhjen në Gjirin e Ramshpatit. Në zonën e Ishmit, si rrjedhojë e punës së njeriut dhe relievit kodrinor, janë ngritur rezervuare ku theksojmë rezervuarin e Tarinit si një ndër më të mëdhenjtë në Shqipëri. Rezervuarë të tjerë janë rezervuarët e Qerretit dhe Tapanasë. Përroi I Tarinit që bashkohet me përroin e Tapanasë e që derdhet në Gjirin e Lalësit, shërben si kufi natyror midis kësaj komune dhe bashkisë Manëz. Zona eshte nje vend bregdetar qe eshte perdorur , krahas aktivitetit bujqesor, edhe si vend pushimi gjate stines se veres. Ujerat nentokesore variojne nga 1.0 deri 1.3 m nen nivelin e tokes ne Ishem dhe arrin ne nivelin e tokes prane bregut te detit. Kompania ka shpuar per qellime personale nje pus te cilit i ka kryer analizat dhe e perdor per nevojat e kompanise. Procesi teknologjik i aktivitetit eshte shume i thjeshte dhe nuk do kete ndikim ne ujerat

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



siperfaqesore dhe nentokesore te zones. Gjate funksionimit te aktivitetit nuk parashikohen shkarkime mbetjesh te demshme ndotese, ne ajer dhe ne toke.

f. Relievi dhe klima

Në Ishëm dominon një reliev kodrinor i rrethuar nga dy fusha të mëdha në perëndim me Gjirin e Lalëzit (Shënpletër, Fushë Bizë, Rrotull) dhe në lindje me Fushën e Thumanës. Ishmi karakterizohet nga një klimë e butë me influencë nga deti. Karakterizohet dhe si zone me reshje të konsiderueshme. Më poshtë po japim disa të dhëna lidhur me kushtet klimaterike në kete zonë.

- Orë me diell 1,900 deri 2,200
- Dite me vranësira dhe shi 140
- Ditë me diell 220
- Reshje 1,200-1,400 mm shi në vit

g. Trashegimia arkitektonike dhe historike.

Komuna Ishëm është pjesë administrative e Qarkut Durrës dhe ndodhet në veri të territorit të tij ku ndahet qartë (si territor) nga lumi Ishëm në veri dhe nga Përroi i Tarinit në jug. Ka një sipërfaqe totale prej 8,000 ha duke u kufizuar në juglindje me komunën e Prezës, në perëndim me detin Adriatik dhe në lindje me komunën Thumanë të rrethit të Krujës. Komuna Ishëm përbëhet nga 10 fshatra: Kuraten (Shkafanë), Lalës, Likmetaj, Kërtushaj, Kapedanaj, Gjiricaj, Rrotull, Draç e Fushë-Draç, Shetaj dhe Bizë. Toponimi “Rodon” rrjedh nga lashtësia Ilire, besimi pagan dhe besimi politeist (në shumë zota apo kulte), njëri prej të cilëve ishte dhe besimi tek Zoti (kulti) i Detit. Rajoni përreth Kepit besonte tek hyjnia e detit me emrin “Rodon” (Arden). Këtij të fundit, iu blatua kepi me gjithë bukuritë e tij natyrore të cilat ky zot i gdhendi me emrin e tij. Më pas, populli e quajti “Kepi I Rodonit”. Në thellësitë e ujërave të kepit ndodhen gërmadhat e qytetit të lashtë. Sipas albanologut të njohur Eqrem Çabej, Ishmi ka një gjenezë para 3 mijë vjeçare si vendbanim shumë i lashtë, i pagëzuar në gjuhën pararendëse Ilire me emrin “Isamus”, “Issamus”, “Issam”, “Issemus”, “Ismus”, “Istiamus”, “Istm”, “Durachium”, “Lissus”, “Skodra”, “Seupi”. Ishmi me këto emërtime është i njohur në arkivat e Raguzës së shekujve XIV – XV. Topiajt kanë sunduar si principatë në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe këtë e dëshmojnë kisha bizantine e “Shën Nastasia” (Saneta Nastasia), Deti Arderi e Radonit (sipas burimeve raguziane). Në vitet 1420 - 1450, Rodoni zotërohej nga venedikasit. Në vitin 1450, pas fitores së Skënderbeut në rrethimin e parë të Krujës, ky i fundit vuri nën zotërim Kepin e Rodonit. Historia e lashtë është e incizuar në monumente historike në kisha antike, në kështjella, në bazilika dhe në ndërtime të vjetra popullore të skalitura fort në memorien e komunitetit të Ishmit. Kalaja e

FREDI Sh.p.k

Fshati Rrotull, Komuna Ishem, Durres

Rr. Reshit Collaku, Shk.12 Ap.169

Tirana - Albania

infoeg09@gmail.com

mobile: +355 696032083



“ FREDI” Sh.p.k

E&G 09 shpk



Rodonit e ndërtuar në anën verilindore të kepit mbi themelet e antikitetit, që ka qenë rezidenca e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu nga ku nëpërmjet mjeteve sinjalizuese mesjetare, siç ishte zjarri, mbante lidhje me kështjellën e Krujës. Ruhet dhe janë shpenzuar fonde nga shteti për restaurimin e saj. Pjesa më e madhe e kështjellës është fundosur në ujë .

Kisha e Shën Ndout: sipas mitologjisë thuhet se “Shën Ndou erdhi nga sheshi i Shën Pjetrit në Vatikan dhe qëndroi në Rodon dhe u vendos në Kurbin. Në përgjigje të këtijudhëtimit u ndërtua kisha që mori emrin e të shenjtit Ndou me emrin “Kisha e Shën Ndout”. Kisha është ndërtuar në bazë të stilit bizantin dhe më vonë të atij romak, vjen si rrjedhojë e futjes së territoreve ilire nën sundimin bizantin dhe pjesa veriore e Shqipërisë ishte e besimit katolik perëndimor. Kjo duket qartë dhe në afresket brenda mureve të saj. Ky monument është restauruar nga shteti duke marrë imazhin e plotë të institucionit bashkëkohës. Thëksojmë se dhe gjatë periudhës në të cilën ishte ndaluar besimi fetar në këtë objekt zhvilloheshin pelegrinazhe në fshehtësi. Pas viteve 1990 pelegrinazhi fetar në këtë kishë zhvillohet në mënyrë ceremoniale nën drejtimin e kishës katolike Bizë çdo date 13 qershor si ditë e shenjtë e Shën Ndout. Donika, motra e Skënderbeut, kaloi këtu muajin e mjalit dhe për nder të kishës ndërtoi edhe manastirin, i cili është në rikonstruksion e sipër.

